Montim Ligjor – 24.11.2015

Pershendetje.

Duke marre shkas nga shume komente dhe pyetje qe me kane ardhur po bej edhe nje koment tjeter , ndonese e di qe nuk ka asnje vlere (edhe te une ka pesimizem).

Faktet:

1.Nga data 31 dhjetor 2014 e perpara ka qene:

VENDIM Nr. 457, datë 9.7.2014
III. LLOJET, SHUMA DHE SHPËRNDARJA E KONTRIBUTEVE

6.I vetëpunësuari, …… duke filluar nga data 1.8.2014 e në vazhdim, **të paguajë** për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore, **në masën 23 për qind të pagës mujore minimale** prej 19 406 lekësh, e barabartë me 4 463 lekë në muaj.

2.Nga data 1 Janar 2015 dhe sot eshte:

VENDIM Nr. 77, datë 28.1.2015
II. PAGA PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË KONTRIBUTEVE

3.Paga bruto mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore, nga data 1.1.2015 e në vazhdim, të jetë, si më poshtë vijon: **jo më pak se sa paga minimale**, e barabartë me 22.000 (njëzet e dy mijë) lekë dhe sipas përcaktimit të vetë personit, **deri 97.030 lekë**, për personat e vetëpunësuar;

3.Nga data 1 Janar 2016 e ne vazhdim do te jete:

sipas pages maksimale prej 97.030 leke (te pakten keshtu jane gjasat) po ricitoj perseri relacionin e ndryshimit

Nëse do të krahasojmë një të punësuar në një kompani X, që merr një pagë prej 100 mijë lekësh në muaj, dhe një avokat, rezulton se, me normat në fuqi, baza e llogaritjes së kontributeve është, si më poshtë:

Kontribute	I punësuar	Avokat
Kontribute shoqërore	23,772	5,060
Kontribute shëndetësore	3,400	1,496
Total	**27,172**	**6,556**

*Pra, një avokat paguan 6 556 lekë në muaj kontribute, ndërsa i punësuari paguan 27 172 mijë lekë në muaj. Pikërisht për të hequr këtë shtrembërim fiskal propozohet ky ndryshim në të treja ligjet që lidhen me pagesën dhe normat e kontributeve, të cilat, në finale, janë në **përfitim të vet profesionistëve të lirë**, sepse, **duke kontribuar më shumë sot**, në sistemin e kontributeve, **do të marrin më shumë përfitime si në pensione** edhe në sistemin shëndetësor.*

KOMENTI :

Ndryshimi (ose ndryshusi po ta kthesh ndryshe) , presupozon, qe profesionet e lira, te kene perfitim, pasi duke paguar kontribute mbi , pagen maksimale, **do te kene nje pension te larte neser**, qe i takon kohes se ardhme. **Por por por.**

1.Kete nder qe na ben me detyrim (se nder me detyrim nuk ka) ky ndryshim rrealisht ne baze te VKM mesiperme egziston , pasi per ate qe ka interes edhe **sot eshte e ligjeruar** dhe mund te paguhet kontribut maksimal, ose e thene ndryshe deri me 31 dhjetor 2014 nuk mund te paguaje kontribut me shume se minimalja ndersa duke e vleresuar drejt ligjvenesi e liroi dhe dha mundesi **per ate qe do, te paguaje sigurime edhe maksimale** per te rregulluar pensionin,
Pra nderin e kemi, ndersa **ndryshimi** do te na beje nder! Si duhet kuptuar???

2.Po ne rastet kur del ne pension dhe don te vazhdosh te punosh duke paguar perseri sigurimin maksimal cili do te jete perfitimi i mevoneshm **apo do kete perfitim ne shpenzimet e varrimit????**
3.Po ne rastin qe nje vajze e re apo djale i ri i dipllomuar dhe i liçensuar do te hyje ne treg dhe qe muajin e pare duhet te marre borxh te komshiu qe te paguaje sigurimin maksimal (pa llogaritur nevojat jetike) ky ndryshim e ben optimist apo pesimit, e motivon apo e frenon dhe e demoralizon?
4.Ai i shkreti, nuk e di qe i punesuari me 100.000 leke page nuk paguan 27.132 leke kontribut me 27.9%, por me 11.2% pasi pjesen tjeter e paguan punedhenesi dhe ne kete kuader, me drejt, do te ishte thenia qe, nga i punesuari me 100.000 leke page **shteti merr** 27.132 leke ndersa nga avokati 6556 leke dhe **duhet korigjuar, qe shteti te marre njelloj nga te dy, dhe jo qe ka hallin e pensionit te avokatit.**
5. Sinqerisht do te doja ta dija se cili do te ishte motivi: mllef,xhelozi profesionale, paaftesi, ligesi apo mendjelehtesi se per profesionalizem dhe seriozitet as qe behet fjale.
Perfundimisht duke Ju falenderuar qe patet durim ti lexoni keto rrjeshta, per ta mbyllur, por dhe duke Ju bere me dije qe une personalisht nuk e kam kete problem, pasi nuk jam i vetepunesuar, do citoje shprehjen e fameshme nga Bibla “Fali Zot se s’dine ç’bejne”